POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

7 lëvizjet e gjyqtarit që liroi Lul Berishën nga burgu për t'i shpëtuar Vetingut, shkarkimi i tij u monitorua nga prokurori amerikan

2

Vijojnë ndryshimet në Policinë e Shtetit, ikën Dhimitraq Ziu nga policia rrugore, emërohet Altin Qato

3

SHBA/ Përleshja në Kishën Katolike, qytetari me maskë sulmon priftin At Bunet

4

E moshuara: Mos mbetem sakate! Ra Të kanë marrë mës do të ngrihesh në këmbë

Lajmi i fundit

SHBA/ Përleshja në Kishën Katolike, qytetari me maskë sulmon priftin At Bunet
29 Tetor, 03:17

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Kronikë

VIDEO/ Ekzekutohet me kallashnikov Demir Backa, vëllai i ish-anëtarit të bandës së Fierit i vrarë në '97! Dy autorët qëlluan nga një makinë në lëvizje, u larguan drejt Vlorës

Vritet me breshëri kallashnikovi pronari I lokalit Piazza në qendër të qytetit të Fierit Demir Backa. 57-vjeçari është ekzekutuar brenda mjetit të tij nga një tjetër makinë në lëvizje. 2 autorët më pas kanë djegur mjetin në bypass-in e Fierit.

- Kush është Demir Backa, vëllai i ish-anëtarit të bandës së Fierit i vrarë në '97 në Masakrën e Levanit
- Atentati në Fier/ Gjendet e djegur një makinë në fshatin Daullas, dyshohet të jetë e autorëve, policia nis hetimet

Redaksia
23 Tetor, 20:50 | Përditesimi i fundit: 24 Tetor, 08:42

FIER- Një atentat me breshëri kallashnikovi nga ndodhur në qytetin e Fierit. Objektiv i ekzekutimit ka qenë Demir (Demi) Backa pronar i lokal 'Piazza' në qendër të qytetit. 57-vjeçari mbeti i plagosur nga atentati dhe u dërgua në spitalin e Fierit, por nuk ka mundur t'i mbijetojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë. Ngjarja ka ndodhur pranë qendrës tregtare në Fier, një zonë mjaft e populluar.

Në orën 20:40, në vendin e quajtur "Rrethrrotullim i QTU-së", teksa Demir Backa ndodhej brenda mjetit të tij tip "Audi", në parkim, është qëlluar me breshëri kallashnikovi nga një mjet tjetër në lëvizje tip "Benz".


LEXO EDHE:
Dhunoi tregtarin pak ditë më parë në Lushnje pse refuzoi kontrollin, pezullohet efektivi i policisë

Mendohet se kanë qenë 2 autorët brenda mjetiti tip "Benz", të cilët pasi kanë ekzekutuar 57-vjeçarin, janë larguar në drejtim të Vlorës. Ata kanë djegur mjetin me targa tw vjedhura në Bypass-in e Fierit, në fshatin Daullas.

Mendohet se autorët e kanë ruajtur prej ditësh Demir Backën, dhe e kanë vëzhguar para se të kryenin atentatin. Demir (Dem) ishte vëllai i ish-anëtarit të bandës së Fierit i cili është vrarë në 1997-ën, Medi Backa, i njohur si Buc Backa.

Buc Backa u vra në masakrën e Levanit, së bashku me 23 persona të tjerë. Janë bërë më shumë se 20 vite nga ngjarjet e tmerrshme të vitit 1997, ndërsa nuk dihet nëse vrasja e Demir Backës ka lidhje më këtë masakër.

Për ngjarjen policia e Fierit, Forca e Posaçme "Shqiponja" dhe 2 grupe të FNSH kanë shkuar në vendngjarje dhe po krehin zonën për kapjen e autorit. Ndërkohë janë ngritur disa pika kontrolli në hyrje dhe dalje të qytetit të Fierit.

[Shqiptarja.com]
Viktima Demir Backa

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 23:10

Kush është Demir Backa, vëllai i ish-anëtarit të bandës së Fierit i vrarë në '97 në Masakrën e Levanit

Demir (Dem) Backa i ekzekutuar ditën e sotme pranë një qendre tregtare, ishte pronar i Bar-Restoranti "Piazza" në Fier. Në QKB biznesi rezulton i regjistruar në emër të tij që në vitin 2013, në lagjen Apollonia, rruga "Jakov Xoxa", të Fierit.

Backa ishte vëllai i ish-anëtarit të bandës së Fierit i cili është vrarë në 1997-ën, Medi Backa, i njohur si Buc Backa.

Buc Backa u vra në masakrën e Levanit, së bashku me 23 persona të tjerë. Janë bërë më shumë se 20 vite nga ngjarjet e tmerrshme të vitit 1997, ndërsa nuk dihet nëse vrasja e Demir Backës ka lidhje më këtë masakër.

Masakra e Levanit konsiderohet si më e madhja që ndodhi gjatë trazirave të vitit 1997 ku në rrethana ende të paqarta u vranë 24 persona gjatë një përplasjeje me armë që zgjati dy orë.

Janë bërë më shumë se 24 vite nga ngjarjet e tmerrshme të vitit 1997, ndërsa kjo masakër do të kujtohet si ngjarja kur u vranë 24 persona në vetëm 6 minuta.

14 prej tyre ishin anëtarë të një prej bandave më të rrezikshme të jugut, të cilët ishin nisur për të zhdukur bandën e Zani Çaushit dhe Komitetet e Shpëtimit, të cilët atë natë kishin vendosur të mblidheshin në Vlorë.


Kopje nga web

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L32605405K
2. Emri i subjektit	Demir Backa
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	05/02/2013
5. Fusha e veprimtarisë	Bar Restorant, berbime dhe tregti te mallrave te ndryshem shumic e pakice.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Fier Fier FIER Lagjja Apollonia, rruga "Jakov Xoxa", banesa private 4 kateshe.
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: PIAZZA Telefon: 0696065639 0692078104
9. Statusi	Aktiv

Lista e Dokumenteve:
Dokumenti i autorizimit

Regjistrimi Fillestar: CN-003925-02-13

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
26/11/2013	Numri i ceshtjes: CN-265305-11-13 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Hapja e dy adresave sekondare. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Shtuar Adresa: "Fier; FIER; Fier; ; FIER; Lagjja"Apollonia"rruga"Jokov Xoxa",godine 4 kateshe,kati i 1.; "

1

(Kliko këtu për të aksesuar ekstraktin e plotë)

Ora 22:00

Atentati në Fier/ Gjendet e djegur një makinë në fshatin Daullas, dyshohet të jetë e autorëve, policia nis hetimet

Mbrëmjen e sotme u ekzekutua në Fier Demir (Demi) Backa. Dy autorët me një automjet tip "Benz" kanë qëlluar me kallashnikov drejt 57-vjeçarit. Burime bëjnë me dije se fshatin Daullas është gjetur e djegur një makinë tip "Benz", e cila dyshohet të jetë e autorëve. Ekspertiza policore ndodhet në vendngjarje për të zbuluar nëse makina e djegur u përket autorëve. Report Tv siguron pamjet ekskluzive nga vendi i ngjarjes tek i cili aktualisht po vijojnë hetimet.

I.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Fier te shtena me arme ekzekutim me armë zjarri Demir backa

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Basha sulmon Berishën, Metën e Ramën e thotë se koha e tyre mbaroi, a jeni dakord?
Po Jo Të ikë edhe vet

Komento

Komente

Hasta el fuego: 24/10/2021 10:05
Ja dhe nje luft e re ne fier ky ishte kusuri qe Beni duhej ti kthente Demes pas rrahjes qe i bani Dema,dhe Ben Qimja do te tregonte forcen perball kundershtarve te ti qe vonon po nuk harron...e paci nis me kam te mar hahahahah
Përgjigju

Qwert: 24/10/2021 08:38
Pabesia qe i beri qimes ka vetem nj pergjigje ...vdekje kujtonte se do shpetonte me at pabesi qe beri ..beni vajti te sqarohesh si burri me burrin po kosovaret e fierit e kan ne gjak pabesin ...tani kosovaret do ti rrujn k .. benit
Përgjigju

> **Cami:** 24/10/2021 18:23
> nuk ka mare afmen mos ja fut kot ju hodh siper mu te qenda ka mundesi te turizmi i xhikes dhe ai e ka emrin renato
>
> **per ty kurioz:** 24/10/2021 15:07
> backat jan fisi madh po jo vllezer te gjith me kete ky dy pleq ka vllezer plus kan dhe 1 moter qe ua vran çamet e malit ne 98 per arsye se ajo mori armen ne dor kur ju vra burri vet kujtim ulaj vellai gim ulajt i vrare dhe ky . tani te shofim
>
> **Kuriozi:** 24/10/2021 09:56
> Ca pabesie i ka bo qimes ky? Pse thojn te gjith ktu e ka vra qimja? Po kto backat jan te forte nr fier. Nese jan i bie qe paska plas lufta ne fier

Aaa: 24/10/2021 05:38
Po kur jeni ba trima edhe ju laluca???!!! Ore,Labi,di not ti... hahhaha
Përgjigju

Kthese e Patosit: 24/10/2021 03:34
Qimja te hyje ne tunel atomik tani, se ska shpetim. Jashte Shqiperie e tredhin, ne Fier i iken koka, si e Ali Pashait. Zgjidh dhe merre Qime tani?
Përgjigju

> **Qimja:** 24/10/2021 08:40
> Ore edi qe ke te drejt ti qe do rri ne tunel po mos te merzitem ma siell at motren ketu brenda ta guxhlis cik une.
>
> **zarifi:** 24/10/2021 07:02
> qimja die ishte mu ne mes te fierit sa per djeni ama me 15 veta jo me larg nga die

Shoku: 24/10/2021 02:05
Ujku mjegull do,asnjeri nuk e gjeti pse?
Përgjigju

Qamil: 24/10/2021 00:19
I doli tymi asaj rrahjes se 2017 te piazza
Përgjigju

> **Kuriozi:** 24/10/2021 01:32
> Ca rrahje? Ca ka rraf ky ne 2017 o qamil

Qimja: 23/10/2021 23:50
Qimjaaaaa
Përgjigju

Buc backa: 23/10/2021 23:32
Ore mos eshte ai mubabeti I asaj rrahjes se famshme qe ndodhi ne fier?
Përgjigju

> **Timi:** 24/10/2021 10:30
> Nuk e ka rrah njeri Ben qimen, vetem te birin nje shpulle aq, Mos flisni sikur dini shume, se as per fytyre si keni pa ndonjehere, Vetem ne tv i keni degju po flisni me bindje. Sa per kosovare, ka shume ne fier dhe problematike njifen Qe ne 96-97. Po tymi i dalte..
>
> **@Labi:** 24/10/2021 00:29
> Rrahjes se Ben Qimes
>
> **Buc backa:** 23/10/2021 23:56
> Po rrahen nje te forte ata,mbase eshtw zgjuar nga gjumi
>
> **Lushnja:** 23/10/2021 23:51
> Kush jane 2 super rrahjet qe kane ndodhur ne fier ?
>
> **Labi:** 23/10/2021 23:44
> Ciles rahje?
>
> **çameria:** 23/10/2021 23:39
> per ke e ke fjal buço se ne fier vitet e fundit kan ndodhur 2 super rrahje

fieri: 23/10/2021 23:31
dem backa nuk e kishte vlla buc backen po djal xhaxhai
Përgjigju

çami: 23/10/2021 23:23
heret a von do ndodhte
Përgjigju

> **@Juli:** 24/10/2021 10:46
> Për kë thua ti për Olsin?
>
> **Vlor:** 24/10/2021 08:42
> Po ik mor lapanjos ..more bixhdil
>
> **Juli:** 24/10/2021 02:03
> Po ben qimja e ka vrare me niprit e ede keckes se ate mbane per te vrare ai ate kulishin e bushtres nga colja qe ri tani me ata te oslos e di policia dhe nuk bene gje

Lajme të tjera

Sociale

Nisma 'Punë për Komunitetin' financuar nga qeveria gjermane për të tretin vit radhazi në Fier, kryebashkiaku: Janë punësuar 100 punëtorë sezonal
28 Tetor, 11:48

Kronikë

Pak ditë para skadimit të marrëveshjes me qeverinë, naftëtarët në Ballsh, sërish para uzinës: Ende s'ka vendim çfarë do bëhet me ne
28 Tetor, 10:11

Kronikë

Fier/ 38-vjeçari thyen xhamin e qendrës shëndetësore pas sherrit me mjeken, një tjetër në pranga për lojëra fati
28 Tetor, 09:18

Politikë

Debate në Komisionin e Sigurisë/ Opozita: Vrasja në Fier dhe grabitja në Nikël, tregon që qytetarët s'kanë besim te Policia! Ministri hesht: S'kam koment
27 Tetor, 15:18

Kronikë

Rrahin dhe kërcënojnë 78 vjeçaren, nusja e djalit fëmijëve: Goditeni me gur, unë do e helmoj
26 Tetor, 22:11

Kronikë

Ekzekutimi i Demir Backës në Fier, policia i shkon disa herë në shtëpi 'Ben Qimes' për ta marrë në pyetje, por nuk e gjen, familjarët: Është me punë në Tiranë
26 Tetor, 11:30

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje